



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	10.05.2024
REFERENC-Ë:	23/5592/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Elan Petrol" Sh.p.k, Stacioni Karburanteve, Vushtri.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka kontrolluar dokumentacionin për t'u pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Elan Petrol" Sh.p.k, Stacioni Karburantit, Pestovë, Vushtri me Nr.Prot. 23/5592/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

1. Vendimi për **Refuzimin** e kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore, "Elan Petrol" Sh.p.k, Vushtri i **Refuzohet** kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore për Stacionin e Karburantit, Pestovë, Prishtinë

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Nr.: 23/5592/MMPHI  
Datë: 10.05.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

Operatorit "Elan Petrol" Sh.p.k, Vushtrri i **Refuzohet** kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore për Stacionin e Karburantit, Pestovë, Prishtinë.

**A r s y e t i m**

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 17.3402/2-ZSP/247/17, të lëshuar me dt. 21.09.2017

Faqe 2 nga 3



Operatori nuk ka plotësuar kushtet si më poshtë :

- Leje Ujore për shfrytëzim dhe
- Leje Ujore për shkarkim.

Komisioni për Leje Mjedisore në takimin e mbajtur të datës: dt.10.05.2024, konstatoi se operatori nuk i plotëson kriteret e parapara për pajisje me Leje Mjedisore, pasi që nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë.

Andaj bazuar në faktet e cekura më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **Refuzon** kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore, në përputhje me nenin 12 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Vushtrri;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.